

VENDIM
Nr.1124, datë 30.7.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PROCEDURAVE DHE KRITEREVE PËR
PAJISJEN ME CERTIFIKATËN E SPECIALISTIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË
MJEDIS DHE AUDITIMIN MJEDISOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 31 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave, të procedurave dhe të kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, si më poshtë.

2. Të drejtën për t’u pajisur me certifikatë e kanë specialistët e diplomuar në fushën e mjedisit ose të agromjedisit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në universitete private ose në universitet jashtë shtetit. Certifikata e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor jepet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

3. Për pajisjen me certifikatë si specialist për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor, i diplomuari, sipas pikës 2 të këtij vendimi, paraqet në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave një kërkesë, të shoqëruar me autodeklarimin ku, veç të tjerave, dëshmohet diplomimi dhe përvoja e punës në fushën e mjedisit, jo më pak se pesë vjet.

4. Të diplomuarit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, që kërkojnë të certifikohen, u nënshtrohen provimeve në Universitetin Politeknik të Tiranës ose në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

5. Programet dhe procedurat e zhvillimit dhe të vlerësimit të provimeve përcaktohen nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

6. Provimet për pajisjen me certifikatë si specialist për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor zhvillohen 2 herë në vit.

7. Komisioni i vlerësimit të provimit dorëzon, për nënshkrim, brenda 5 ditëve nga data e zhvillimit të provimit, përmbledhësen e rezultateve të provimit për të gjithë konkurruesit te dekan i fakultetit përkatës, ku është zhvilluar provimi. Rezultatet afishohen në mjediset e fakulteteve përkatëse dhe një kopje i dërgohet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

8. Në bazë të rezultateve të provimit, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave lëshon certifikatën, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së rezultateve përfundimtare të provimit.

9. Personat juridikë certifikohen në bazë të certifikatave personale, që u janë dhënë të paktën dy prej specialistëve të tyre.

10. Personat juridikë, për t’u pajisur me certifikatë, paraqesin në ministri:

a) kërkesën;

b) kopje të noteruar të certifikatave të jo më pak se dy specialistëve të tyre;

c) kontratën e punës me specialistët e certifikuar;

ç) vërtetimin e regjistrimit nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR).

11. Për evidentimin e specialistëve të pajisur me certifikatë, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave krijohet regjistri kombëtar i specialistëve të certifikuar, sipas rregullave të miratuara nga ministri.

12. Regjistri është i disponueshën për publikun, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e administrimit të tij.

13. Certifikata shpallet e pavlefshme me urdhër të veçantë të ministrit, kur provohet se specialisti ka mashtruar me të dhënat e paraqitura në dokumente. Urdhri, që shpall të pavlefshme certifikatën, publikohet.

14. Ndaj refuzimit të kërkesës për t’u pajisur me certifikatë, si dhe ndaj urdhrit për shpalljen e

pavlefshme të certifikatës, specialisti mund të ankohet në rrugë administrative dhe në gjykatë, brenda një muaji nga data e refuzimit ose e daljes së urdhrit.

15. Kur specialisti i certifikuar emërohet në administratën publike, në një detyrë, që mbart konflikt interesash, certifikata nuk përdoret prej tij për aq kohë sa është në atë detyrë.

16. Për shqyrtimin e kërkesës, aplikanti paguan tarifën e shërbimit, në shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, e cila paguhet me dorëzimin e kërkesës dhe është e pakthyeshme edhe nëse kërkesa nuk miratohet. Të ardhurat nga tarifat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

17. Certifikatat e lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi mbeten të vlefshme.

18. Vendimi nr.268, datë 24.4.2003 i Këshillit të Ministrave “Për certifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, shfuqizohet.

19. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha